

AKT THEMELIMI I SHOQERISE TREGTARE
"BAHCE" SH.P.K.

Sipas Ligjit Nr 9901 dt 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëria Tregtare" dhe Ligjit nr 9723 i 03.05.007 për "Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" themelohet sot në datën 06.05.2021, shoqëria "Bahçe" shpk. Adresa e shoqërisë është Ish Kaldaja provizore nr 4, Zona Kadastrale nr 3965, nr pasurie 481/3, pranë Nermarrjes së Seleksionimit të Metaleve, ish Kombinati Metalurgjik, Bradashesh, Elbasan, me ortakë Z. Yusuf Gökdemir, Ermal Koka dhe Besim Sakajani.

VENDOSI:

Krijimin e një shoqërie tregtare me emrin "Bahçe" shpk. me kushtet e mëposhtme:

Neni 1

Themeluesit, krijojnë shoqërinë tregtare "Bahçe" shpk, me një statusin ligjor të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar në bazë të ligjit nr 9901 të 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", me burimet e veta financiare dhe kontributet e paguara në cash.

Neni 2

Kompania gëzon statusin e personit juridik dhe aktivitetet e saj rregullohen nga legjislacioni shqiptar në fuqi, sipas këtij akt themelimi dhe Statutin e aneksuar.

Neni 3

Kompania do të ushtrojë biznesin e tij nën emrin "Bahçe" shpk, shpk, dhe ky emertim do të shënohet në të gjitha dokumentet, letrat, faturat, etj.


Kompania ka vulën e vet në të cilën është shkruar "Bahçe" shpk, Elbasan, Shqipëri.

Neni 4

Selia e kompanisë është e vendosur në, Ish Kaldaja provizore nr 4, Zona Kadastrale nr 3965, nr pasurie 481/3, pranë Nermarrjes së Seleksionimit të Metaleve, ish Kombinati Metalurgjik, Bradashesh, Elbasan.

Kompania ka kompetenca të hapë dhe të mbyllë agjencitë e tjera në qytete të tjera të Shqipërisë apo jashtë vendit, nëse konsiderohet e nevojshme.

Neni 5



Periudha e aktivitetit të kompanisë do të jetë i pakufizuar, përveç në rastet kur ortaket vendosin shpërbërjen me të hershme e aktivitetit.

Neni 6

Kompania ushtron veprimtarinë e saj me objekt:

Kultivim dhe mbarshtrim i peshkut, shitje dhe tregtim i tij, Ndertim, rikonstruksion, shitje e blerje godina industriale, shtepi, tregtim i materialeve te ndertimit, etj.

Neni 7

Me vendim të themeluesve, kompania mund të ndryshojë emrin, vendin, statusin ligjor dhe qëllimin e punës, mbasi të deklarojë ndryshimet në këtë akt dhe në statutin e saj.

Neni 8

Kapitali i kompanisë i paguar plotësisht në mjete monetare është caktuar fillimisht nga ortaket në masën 100.000 (njëqindmije) leke.

Kapitali shoqërisë përbehet nga tre kuota të cilat zotërohen nga ortaket si vijon;

- Një kuota me vlerë nominale 33.333,33 leke dhe që përfaqëson 33.34 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë zotërohet nga ortaku Yusuf Gökdemir.
- Një kuota me vlerë nominale 33.333,33 leke dhe që përfaqëson 33.34 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë zotërohet nga ortaku Ermal Koka.
- Një kuota me vlerë nominale 33.333,34 leke dhe që përfaqëson 33.34 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë zotërohet nga ortaku Besim Sakajani.

Neni 9



Kompania zhvillon biznesin e saj për të bërë fitime. Ajo është përgjegjëse për detyrimet që ka ndaj shtetit dhe ndaj personave të tjerë, që nga themelimi i saj.

Neni 10

Kompania kryen aktivitetin e saj administrativ, ekonomik e financiar, në përputhje me legjislacionin aktual dhe me statutin e bashkangjitur.

Drejtimi i shoqërisë do të bëhet nga organet e saj drejtuese, të cilat përbëhen prej administratorit të saj.

Ortaket marrin vendim për emerimin e ekspertit kontabel.



Kompania do të mbajë llogaritë në përputhje me ligjin "Për kontabilitetin" dhe do të krijojë një fond rezervë.

Fitimi neto që do të rezultojë në fund të çdo viti financiar, pas zbritjes së fondit rezervë dhe humbjeve të rezultuara nga vitet e mëparshme, do të shpërndahet ortakeve.

Neni 11

Përcaktimi i strukturës organizative të kompanisë, funksionet, dhe dorëheqja e organeve të tij merren nga organet drejtuese.

Administrator i shoqërisë " Bahçe" shpk shpk, emërohet zoti Besim Sakajani me një afat prej pesë vjetësh.


Marrëdhëniet e Punës, do të bazohen në kontratat e punës, dhe në ligjin përkatës.

Neni 12


Rregullat për menaxhimin, organizimin dhe prishjen e shoqërisë, janë përcaktuar në statut që është bashkëngjitur në këtë akt themelimi.

Ortaket e i shoqërisë " Bahçe" shpk


Yusuf Gökdemir



Ermal Koka



Besim Sakajani



STATUTI
I SHOQERISE TREGTARE "BAHÇE" SH.P.K.

Shoqeria tregtare "Bahçe" shpk themelohet sot ne date 06 maj 2021, ne baze te Ligjit nr 9901 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqerite Tregtare".

Kapitulli I
Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Shoqeria " Bahçe ", shpk, është një person juridik.

Kompania fiton statusin ligjor nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit. Ajo e zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe dispozitat e parashikuara në statut dhe ne aktin e themelimit.

Neni 2

Kompania " Bahçe " shpk , është një kompani me përgjegjësi të kufizuar, me seli : Ish Kaldaja provizore nr 4, Zona Kadastrale nr 3965, nr pasurie 481/3, prane Nermarrjes se Seleksionimit te Metaleve, ish Kombinati Metalurgjik, Bradashesh, Elbasan.

Kompania ka kopetenca të hapë dhe të mbyllë filiale, agjenci apo degë të tjera në qytete të tjera të Shqipërisë apo jashtë vendit, nëse konsiderohet e nevojshme.

Neni 3

Kohëzgjatja e kompanisë është caktuar pa afat , përveç rasteve kur ortaket vendosin mbylljen e saj.

Neni 4



Emri i kompanisë do të jete " Bahçe " shpk .

Ky emertim do te vendoset në të gjithë korrespondencën, në fature në promocione, në reklama, e ndjekur nga inicialet sh.p.k. (shoqeri me përgjegjësi të kufizuar), dhe nga NIUS, qe jepet nga QKR.

Kapitulli II
Aktiviteti

Neni 5

Kompania ushtron veprimtarinë e saj me objekt:



Kultivim dhe mbarshtrim i peshkut, shitje dhe tregtim i tij, Ndertim, rikonstruksion, shitje e blerje godina industriale, shtepi, tregtim i materialeve te ndertimit, etj. ,

Neni 6

Themeluesit e kompanisë kane të drejtë të ndryshojnë në çdo kohë objektin e kompanisë.

Kapitulli III Kapitali i shoqerise

Neni 7

Kapitali i kompanisë i paguar plotesisht ne mjete monetare eshte caktuar fillimisht nga ortaket në masen 100.000 (njeqindmije) leke.

Kapitali shoqerise perbehet nga tre kuota te cilat zoterohen nga ortaket si vijon;

- Nje kuote me vlere nominale 33.333,33, leke dhe qe perfaqeson 33.34 % te kapitalit te regjistruar te shoqerise zoterohet nga ortaku Yusuf Gökdemir.
- Nje kuote me vlere nominale 33.333,33 leke dhe qe perfaqeson 33.34 % te kapitalit te regjistruar te shoqerise zoterohet nga ortaku Ermal Koka.
- Nje kuote me vlere nominale 33.333,34 leke dhe qe perfaqeson 33.34 % te kapitalit te regjistruar te shoqerise zoterohet nga ortaku Besim Sakajani.

Kapitulli IV

Neni 8

Ortaket i ushtrojne kopetencat e tyre në përputhje me ligjin nr 9901 i dates 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqerite Tregtare".



Ortaket marrin vendime për zhvillimin e aktivitetit, dhe mbi të gjitha për politikën ekonomike dhe tregtare të shoqerise.

Neni 9

Vendimet e ortakeve merren duke u bazuar ne statutin dhe aktin e themelimit te shoqerise.

Ortaket vendosin për çështjet e mëposhtme:

- Miratimi i strukturës organizativa të shoqërisë dhe numrin e njerëzve të punësuar.
- Emërojnë dhe shkarkojne administratorin e shoqerise.
- Administrator i shoqerise emërohet Z. Besim Sakajani, për një periudhë prej pesë vjetësh.
- Ndryshimet në statutin e shoqerise, të kapitalit aksioner të shoqërisë, ne aktivitetin dhe formën e saj ligjore.
- Vendosin per miratimin e llogarive vjetore te pergatitura nga kontabilistet e shoqerise.
- Vendosin per mbylljen e shoqërisë, para afateve te parashikuara në aktin e themelimit dhe statutin e saj, ose zgjatjen e afateve te parashikuara ne to.



- Vendosin për të zmadhimin ose zvoglimin e kapitalit të shoqërisë.
- Riorganizimin, shpërbërjen e shoqërisë dhe likuidimin e kësaj të fundit.
- Orientimet mbi bazën e të cilave shoqëria do zhvillojë aktivitetin, politiken ekonomike dhe tregtare të shoqërisë.
- Vendosin mbi fillimin e aktiviteteve të reja sipërmarrëse dhe tregtare nga ana e shoqërisë.
- Vendosin mbi përdorimin e hipotekës, të pengut ose garancive të tjera.

Neni 10

Administratori ka të gjitha kompetencat e nevojshme për të hyrë në marrëdhëniet me të tretët në emër të kompanisë, përveç kompetencave të parashikuara në ligjin nr 9901 prej 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëria Tregtare".

Administratori është përgjegjës për aktivitetin operativ të shoqërisë, dhe mund të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme për aktivitetet e saj.

Administratori i shoqërisë përfaqëson shoqërinë në të gjitha marrëdhëniet juridike dhe financiare me të tretët, bankat, kompanitë e transportit, etj.

Neni 11

Ortakët emërojnë deri në dy eksperte kontabel për një periudhë prej 1 vit për të kontrolluar aktivitetin e shoqërisë.

Ekspertet kontabel bëjnë verifikime mbi aktivitetin financiar nepermjet kontrolleve periodike, duke u konsultuar me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për kryerjen e aktivitetit të tyre.. Dokumentacioni i shoqërisë do të vihet në dispozicion të ekspertëve, me qëllim përmbushjen e detyrave të tyre.

Kapitulli V

Aktiviteti i shoqërisë

Neni 12

Viti ekonomik - financiar fillon 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti.

Viti i parë do të fillojë në datën e themelimit të shoqërisë.

Pagesa e taksave, tatimeve dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, behen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 13

Llogaritë e kompanisë do të mbahet në lekë dhe në valutë të huaj dhe bilanci do të hartohet në përputhje me ligjin nr 9228 të 29.04.2004 "Për kontabilitetin"

Neni 14

Punësimi i personelit, kualifikimet e duhura, përcaktimin e pagës për secilin punonjës, dhe shkarkimi i mundshëm i tyre është kompetence vetem e administratorit të shoqërisë.

Marrëdhëniet e punës midis shoqërisë si punëdhënëse, dhe personave të punësuar, do të bazohen në kontratat e punës të parashikuara në legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

KREU VI

Shpërbërja dhe Likuidimi

Neni 15

Shpërbërja e shoqërisë mund të bëhet për shkak të:

- Me vendim të ortakeve të shoqërisë.
- Në rast të humbjes së gjysmës së kapitalit aksioner pasi janë shteruar rezervat.
- Nëse ortakët nuk vendosin rritjen e kapitalit ose zvogëlimin sipas legjislacionit.
- Në rast të shpërbërjes së kompanisë procedohet në likuidimin e saj.
- Ortakët duhet të caktojnë një ose më shumë persona përgjegjës për likuidim.
- Likuidimi i kompanisë do të kryhet në përputhje me ligjin nr 9901 dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Neni 16

Ortakët duhet të ketë në dispozicion pasqyrat financiare të paktën 15-ditë para mbledhjes të ortakeve për ta miratuar atë.

Dorëzimi i tyre do të bëhet në selinë e kompanisë.


Administratori duhet të përcaktojë rregulla për të bërë të mundur konsultimin me librat e llogarive të shoqërisë së paku dy herë në vit.

Neni 17


Për gjithçka që nuk është e parashikuar në këtë statut, do të zbatohet legjislacioni shqiptar në fuqi.

Ortakët e shoqërisë "Bahçe" shpk

Yusuf Gökdemir



Ermal Koka



Besim Sakajani

